REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2164/2 Prot. Tiranë, më 02.11 2026

V E N D I M

Nr. 330 datë 02.11 2026

PËR
SHPALLJEN E KONKURSIT PËR PRANIMIN E 2 (DY) PUNONJËS, PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 *"Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë"*, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 61, datë 15.09.2026 *"Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027"*, si dhe në shkresën e Dekanit të FVFR me nr. 2164/1 prot., datë 30.10.2026 *"Përcjellje për miratim e kritereve për rekrutimin e 2 (dy) punonjësve, personel akademik kategoria As/Lektor, me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit në FVFR"*, Zv/Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në *web-in* http://www.ust.edu.al të proçedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme pranë Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT

2 (dy) Asistent Lektor

Lënda : **"Bio-shkenca dhe Edukim Shëndetësor"**
Moduli : **"Dietologji – Shëndet Publik"**

Lënda : **"Teori dhe Metodologji e Stërvitjes Sportive"**
Moduli : **"Stërvitje e Adoptuar"**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për 1 (një) Asistent Lektor, në Lëndën; **"Bio-shkenca dhe Edukim Shëndetësor"** dhe në modulin: **"Dietologji – Shëndet Publik"** janë si më poshtë:

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME

a) Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, "Master i shkencave" ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
b) Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8-të. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata;
c) Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
d) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
e) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
f) Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

III. KRITERE SPECIFIKE:

1. Të ketë përvojë profesionale në fushat që lidhen me shëndetin popullatës.

IV. KRITERE PREFERENCIALE:

1. Të ketë botime dhe referime në fushën e kërkuar
2. Të ketë marrë pjesë në trajnime, programe kualifikimi që lidhen me fushat e shëndetit.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për 1 (një) Asistent Lektor, në Lëndën; **"Teori dhe Metodologji e Stërvitjes Sportive"** dhe në modulin: **"Stërvitje e Adoptuar"** janë si më poshtë:

V. KRITERE TË PËRGJITHSHME

a) Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, "Master i shkencave" ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
b) Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8-të. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata;
c) Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
d) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
e) Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
f) Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

VI. KRITERE SPECIFIKE:

1. Të ketë përvojë profesionale në fushën e aktivitetit fizik, stërvitjes së adoptuar, rehabilitimit që lidhen me përshtatjen e aktivitetit fizik sipas nevojave.
2. Të jetë i angazhuar në një nga programet e studimit të Ciklit të Tretë "Doktoratë", pranë UST-së.

VII. KRITERE PREFERENCIALE:

1. Të ketë botime shkencore, studime kërkimore dhe referime në fushën e stërvitjes së adaptuar.
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën e aktivitetit fizik dhe e stërvitjes së adaptuar.
3. Të ketë marrë pjesë në trajnime të ndryshme.

➢ **Vlerësimi i Intervistës:**

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies/kërkimit shkencor nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në Power Point (ppt) dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion/prezantin).
- Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i pregatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 70 pikë nga dosja dhe 30 pikë nga intervista. Kandidati duhet të marrë të pakten 21 pikë nga vlerësimi i dosjes për të kaluar në fazën e intervistës. Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të pakten 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e proçedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.
- Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.

VIII. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

a) Formular aplikimi;
b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)

i) Librezë shëndetësore nga Qëndra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

IX. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet nëpërmjet **rrugës postare**:
- Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit (dërguesi); pastaj sipas renditjes (marrësi) 1) Universiteti i Sporteve të Tiranës, 2) Njësia Kryesore, 3) Njësia bazë, 4) **specialiteti ku aplikon** (lënda), emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

X . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

XI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.

XII. Deri në datën 10.11.2026, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 12.11.2026 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.

XIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.

XIV. Dekanati i FVFR, përcjell listën përfundimtare brenda datës 16.11.2026, për miratim në Rektorat.

XV. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FVFR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *web-in* http:/www.ust.edu.al.

XVI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZV/REKTORI

Prof. Dr. Dhimitraq PRIFTI